



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 62

Tiranë – E mërkurë, 12 prill 2023

## PËRMBAJTJA

|   | Faqe  |      |
|---|---|------|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 200, datë 7.4.2023   | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikim i bllokut të banesave të kufizuar nga bulevardi ‘Çamëria’, rruga ‘Pelivan Leskaj’, rruga ‘Piro Sava’ dhe rruga ‘Kujtim Beqiri’”.....  | 6801 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 201, datë 7.4.2023   | Për përcaktimin e procedurave të trajtimit me ushqim gjatë qëndrimit në punë të punonjësit të Gardës së Republikës.....   | 6803 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 202, datë 7.4.2023   | Për një shtesë fondi në buxhetin e Ministrisë së Kulturës, për vitin 2023, për financimin e projektit teknik të ndërhyrjes emergjente në objektin, Monument Kulture, kategoria I “Ura e Matit”.....   | 6806 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 206, datë 7.4.2023   | Për ngritjen e strukturave dhe autoriteteve përgjegjëse për menaxhimin indirekt dhe ushtrimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit indirekt të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të Programit për Zhvillimin Rural të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimin (IPARD III)..... | 6806 |
| Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 243, datë 31.3.2023  | Për miratimin e modelit të kontratës që lidhet midis përmbauesit gjyqësor privat dhe palës së interesuar për kryerjen e konstatimeve të fakteve, sendeve dhe dukurive lehtësisht të verifikueshme, që nuk kërkojnë njohuri specifike teknike, sipas legjislacionit në fuqi.....   | 6813 |
| Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 19, datë 5.4.2023   | Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë financiare shtesë nga Banka OTP Albania sh.a.....  | 6817 |
| Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 2, datë 30.3.2023 | Bibliografia e Informacionit të Deklasifikuar në AIDSSH.....  | 6818 |





**VENDIM**  
**Nr. 200, datë 7.4.2023**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES  
PUBLIK, TË PRONARËVE TË  
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË  
PRIVATE, QË PREKEN NGA  
REALIZIMI I PROJEKTIT  
“RIKUALIFIKIM I BLOKUT TË  
BANESAVE TË KUFIZUAR NGA  
BULEVARDI ‘ÇAMËRIA’, RRUGA  
‘PELIVAN LESKAJ’, RRUGA ‘PIRO SAVA’  
DHE RRUGA ‘KUJTIM BEQIRI’”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikim i bllokut të banesave të kufizuar nga bulevardi ‘Çamëria’, rruga ‘Pelivan Leskaj’, rruga ‘Piro Sava’ dhe rruga ‘Kujtim Beqiri’”, Bashkia Vlorë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Vlorë.

3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 36 852 455.36 (tridhjetë e gjashtë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e dy mijë e katërqind e pesëdhjetë e pesë pikë tridhjetë e gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 36 852 455.36 (tridhjetë e gjashtë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e dy mijë e katërqind e pesëdhjetë e pesë

pikë tridhjetë e gjashtë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Vlorë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Vlorë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Vlorë.

8. Bashkia Vlorë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Vlorë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Vlorë, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Vlorë për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Bashkia Vlorë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**



LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTT 'RIKUALIFIKIM I BLOKUT TË BANESAVE TË KUFIZUAR NGA BULEVARDI 'ÇAMËRIA', RRUGA 'PELIVAN LESKAJ', RRUGA 'PIRO SAVA' DHE RRUGA 'KUJTIM BEQIRI', BASHKIA VLORË

| PRONARI                            |   | TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË) |              |                  |       |      |                       |                         | TË DHËNAT PËR SHPRONËSIM |                                     |                       |                     |                                      |                        |                             | SHËNIME   |        |
|------------------------------------|---|---|--------------|------------------|-------|------|-----------------------|-------------------------|--------------------------|-------------------------------------|-----------------------|---------------------|--------------------------------------|------------------------|-----------------------------|---|--------|
| Nr.                                | Pronari   | ZK  | Nr. Pasurisë | Lloji i Pasurisë | Volum | faqe | Truall m <sup>2</sup> | Ndërtesë m <sup>2</sup> | Sipërfaqe Truallit       | Çmimi i truallit lek/m <sup>2</sup> | Vlera e truallit, lek | Sipërfaqe ndërtimit | Çmimi i ndërtimit lek/m <sup>2</sup> | Vlera e ndërtimit, lek | Vlera e truall dhe ndërtesë | KUFIZIME SIPAS KARTELËS SË PASURISË   | Adresa |
| 1                                  | Spiro Andon Trifoni   | 8602  | 27/90-ND     | Ndërtesë         | 9     | 64   |                       | 50                      |                          | 10,903.00                           | 0                     | 50                  | 77,514.20                            | 3,875,710.00           | 3,875,710.00                | Konfirmuar nga ASHK Drejtoria Vendore Vlorë<br>C. Të drejtat reale; nr. regj. bosh, datë 1.8.2014, shteti është pronar i pasurisë 27/40-T vol. 9 faqe 57 mbi pasurinë 27/40-ND.<br>D. Kufizimet e pronësisë: me nr. 00004255, datë 1.8.2014. Në bazë të vërtetimit të faktit juridik nr. 384 Andon Trifoni ka në pronësi pasurinë nr. 27/90-ND. | Vlorë  |
| 2                                  | Albana Piro Çela  | 8602  | 27/90+1-2    | Apartament       | 6     | 79   |                       | 70                      |                          | 10,903.00                           | 0                     | 70                  | 77,514.20                            | 5,425,994.00           | 5,425,994.00                | Konfirmuar nga ASHK Drejtoria Vendore Vlorë   | Vlorë  |
| 3                                  | Berta Meçani, Kastriot Meçani, Robert Meçani, Natasha Likaj, Suzana Meçani  | 8602  | 27/28+1-1    | Apartament       | 8     | 72   | 0                     | 56.8                    |                          | 10,903.00                           | 0                     | 56.8                | 77,514.20                            | 4,402,806.56           | 4,402,806.56                | Konfirmuar nga ASHK Drejtoria Vendore Vlorë   | Vlorë  |
| 4                                  | Antoneta Haxhi Luloj  | 8602  | 27/28+1-3    | Apartament       | 8     | 74   | 34.4                  | 56.8                    | 34.4                     | 10,903.00                           | 375063.2              | 56.8                | 77,514.20                            | 4,402,806.56           | 4,777,869.76                | Konfirmuar nga ASHK Drejtoria Vendore Vlorë Në bazë të formularit nr. 2 ka privatizuar edhe 34.4 m <sup>2</sup> truall  | Vlorë  |
| 5                                  | Andon Spiro Trifoni, Dhimitraq Andon Trifoni, Kristina Stefan Trifoni, Lorenc Andon Trifoni, Margarita Andon Trifoni, Spiro Andon Trifoni, Suzana Hiraq Trifoni | 8602  | 27/28+2-5    | Apartament       | 8     | 76   | 0                     | 56.8                    |                          | 10,903.00                           | 0                     | 56.8                | 77,514.20                            | 4,402,806.56           | 4,402,806.56                | Konfirmuar nga ASHK Drejtoria Vendore Vlorë   | Vlorë  |
| 6                                  | Aferdita Skenderi, Ali Haxhi Skenderi, Arjan Skenderi, Artur Skenderi   | 8602  | 27/28+2-6    | Apartament       | 8     | 77   | 0                     | 56.8                    |                          | 10,903.00                           | 0                     | 56.8                | 77,514.20                            | 4,402,806.56           | 4,402,806.56                | Konfirmuar nga ASHK Drejtoria Vendore Vlorë   | Vlorë  |
| 7                                  | Albana Piro Çela  | 8602  | 27/28+2-7    | Apartament       | 8     | 78   | 35.2                  | 56.8                    | 35.2                     | 10,903.00                           | 383785.6              | 56.8                | 77,514.20                            | 4,402,806.56           | 4,786,592.16                | Konfirmuar nga ASHK Drejtoria Vendore Vlorë. Në bazë të formularit nr. 2 ka privatizuar edhe 35.2 m <sup>2</sup> truall   | Vlorë  |
| 8                                  | Tatjana Muharrem Hoxhaj   | 8602  | 27/28+2-8    | Apartament       | 8     | 79   | 34.4                  | 56.8                    | 34.4                     | 10,903.00                           | 375063.2              | 56.8                | 77,514.20                            | 4,402,806.56           | 4,777,869.76                | Konfirmuar nga ASHK Drejtoria Vendore Vlorë. Në bazë të formularit nr. 2 ka privatizuar edhe 34.4 m <sup>2</sup> truall   | Vlorë  |
| <b>Vlera totale e shpronësimit</b> |   |   |              |                  |       |      |                       |                         |                          |                                     |                       |                     |                                      |                        | <b>36,852,455.36</b>        |   |        |



**VENDIM**  
**Nr. 201, datë 7.4.2023**

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE  
TË TRAJTIMIT ME USHQIM GJATË  
QËNDRIMIT NË PUNË TË  
PUNONJËSIT TË GARDËS SË  
REPUBLIKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 48, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Trajtimin me ushqim pa pagesë të punonjësit të Gardës së Republikës, si më poshtë vijon:

a) Me një vakt ushqim “drekë”, të gjithë punonjësit e Gardës së Republikës, kur kohëzgjatja e punës, shërbimit dhe trajnimit të tyre është 8 (tetë) orë;

b) Me tri vakte, kur punonjësi i Gardës së Republikës është i angazhuar në shërbime, gatishmëri apo trajnime, me kohëzgjatje 24 (njëzet e katër) orë.

2. Normat e ushqimit ditor, për punonjësin e Gardës së Republikës të jenë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Punonjësit të Gardës së Republikës, që trajtohet me ushqim, sipas shkronjave “a”, dhe “b”, të pikës 1, të këtij vendimi, vaktet e ushqimit, sipas normave të përcaktuara në lidhjen nr. 1, i kompensohen në formë financiare për çdo ditë efektive në punë.

4. Masa e vlerës për kompensimin në lekë për çdo normë të trajtimit me ushqim, është për:

a) normën ditore të ushqimit me një vakt “drekë”, për Njësinë Speciale në Gardën e Republikës, në vlerën 664 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë;

b) normën ditore të ushqimit me një vakt “drekë”, për strukturat e tjera në Gardën e Republikës, në vlerën 556 (pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë;

c) normën ditore të ushqimit me tri vakte, për Njësinë Speciale në Gardën e Republikës, në vlerën 1 382 (një mijë e treqind e tetëdhjetë e dy) lekë;

ç) normën ditore të ushqimit me tri vakte, për strukturat e tjera në Gardën e Republikës, në vlerën 1 193 (një mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë.

5. Vlerat e kompensimit në lekë të normave ditore të ushqimit, të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, dhe “ç”, të pikës 4, indeksohen çdo vit, sipas inflacionit të publikuar nga INSTAT-i.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Brendshme, në programin buxhetor “Garda e Republikës”.

7. Vendimi nr. 638, datë 29.7.2020, i Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me ushqim pa pagesë të punonjësve dhe kursantëve të Gardës së Republikës”, shfuqizohet.

8. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Garda e Republikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**

Lidhja nr. 1

**NORMAT E USHQIMIT DITOR PËR PUNONJËSIN E GARDËS SË REPUBLIKËS**

**Norma ditore e ushqimit me tri vakte për Njësinë Speciale në Gardën e Republikës**

| Nr. | Ushqimet              | Sasia/gr | Energjia k/Cal | Proteinat/gr | Yndyrna/gr | Glucide/gr |
|-----|-----------------------|----------|----------------|--------------|------------|------------|
| 1   | Bukë gruri masive     | 500      | 1225.00        | 50.5         | 11.5       | 245.5      |
| 2   | Oriz                  | 80       | 289.60         | 5.6          | 0.48       | 70.08      |
| 3   | Makarona              | 80       | 284.80         | 8.64         | 0.24       | 66.24      |
| 4   | Fasule                | 80       | 248.80         | 18.88        | 2          | 41.36      |
| 5   | Mish viçi             | 350      | 504.00         | 71.05        | 24.5       | 0          |
| 6   | Vaj ushqimor vegjetal | 20       | 180.00         | 0            | 20         | 0          |



|    |                            |     |                |               |               |               |
|----|----------------------------|-----|----------------|---------------|---------------|---------------|
| 7  | Gjalpë i freskët           | 20  | 151.60         | 0.16          | 16.68         | 0.22          |
| 8  | Sheqer                     | 80  | 313.60         | 0             | 0             | 83.6          |
| 9  | Djathë i bardhë            | 70  | 175.00         | 10.92         | 14.14         | 1.05          |
| 10 | Kos/qumësht                | 500 | 245.00         | 17.5          | 9             | 25            |
| 11 | Vezë (2 kokrra)            | 120 | 187.20         | 15.6          | 13.32         | 1.2           |
| 12 | Patate                     | 200 | 170.00         | 4.2           | 2             | 3.6           |
| 13 | Perime për gatim e sallatë | 450 | 85.50          | 8.1           | 1.8           | 9.9           |
| 14 | Fruta                      | 600 | 270.00         | 1.2           | 1.8           | 66            |
| 15 | Reçel                      | 50  | 104.50         | 0.3           | 0             | 27.6          |
| 16 | Salcë domate               | 10  | 5.00           | 0.09          | 0.04          | 1.14          |
| 17 | Çaj mali                   | 5   | 5.40           | 0.98          | 0.1           | 0.15          |
| 18 | Kripë                      | 10  | 0.00           | 0             | 0             | 0             |
| 19 | Erëza                      | 4   | 2.64           | 0.088         | 0.08          | 0.388         |
| 20 | Miell tip 00               | 15  | 51.45          | 1.65          | 0.105         | 11.7          |
| 21 | Çokollatë                  | 30  | 169.50         | 2.67          | 11.28         | 15.24         |
|    | <b>Totali</b>              |     | <b>4668.59</b> | <b>218.13</b> | <b>129.07</b> | <b>669.97</b> |

Mbyllet me nr. rendor 21 (njëzet e një).

#### Norma ditore e ushqimit me tri vakte për strukturat e tjera në Gardën e Republikës

| Nr. | Ushqimet                   | Sasia/gr | Energjia k/Cal | Proteina/gr   | Yndyra/gr     | Glucide/gr    |
|-----|----------------------------|----------|----------------|---------------|---------------|---------------|
| 1   | Bukë gruri masive          | 450      | 1102.5         | 45.45         | 10.35         | 220.95        |
| 2   | Oriz                       | 80       | 289.6          | 5.6           | 0.48          | 70.08         |
| 3   | Makarona                   | 80       | 284.8          | 8.64          | 0.24          | 66.24         |
| 4   | Fasule                     | 80       | 248.8          | 18.88         | 2             | 41.36         |
| 5   | Mish viçi                  | 250      | 360            | 50.75         | 17.5          | 0             |
| 6   | Vaj ushqimor vegjetal      | 20       | 180            | 0             | 20            | 0             |
| 7   | Gjalpë i freskët           | 20       | 151.6          | 0.16          | 16.68         | 0.22          |
| 8   | Sheqer                     | 60       | 235.2          | 0             | 0             | 62.7          |
| 9   | Djathë i bardhë            | 60       | 150            | 9.36          | 12.12         | 0.9           |
| 10  | Kos/qumësht                | 400      | 196            | 14            | 7.2           | 20            |
| 11  | Vezë (2 kokrra mesatare)   | 120      | 187.2          | 15.6          | 13.32         | 1.2           |
| 12  | Patate                     | 150      | 127.5          | 3.15          | 1.5           | 2.7           |
| 13  | Perime për gatim e sallatë | 450      | 85.5           | 8.1           | 1.8           | 9.9           |
| 14  | Fruta                      | 450      | 202.5          | 0.9           | 1.35          | 49.5          |
| 15  | Reçel                      | 50       | 104.5          | 0.3           | 0             | 27.6          |
| 16  | Salcë domate               | 6        | 3              | 0.054         | 0.024         | 0.684         |
| 17  | Çaj mali                   | 3        | 3.24           | 0.588         | 0.06          | 0.09          |
| 18  | Kripë                      | 10       | 0              | 0             | 0             | 0             |
| 19  | Erëza                      | 3        | 1.98           | 0.066         | 0.06          | 0.291         |
| 20  | Miell tip 00               | 15       | 51.45          | 1.65          | 0.105         | 11.7          |
| 21  | Çokollata                  | 30       | 169.5          | 2.67          | 11.28         | 15.24         |
|     | <b>Totali</b>              |          | <b>4134.87</b> | <b>185.92</b> | <b>116.07</b> | <b>601.36</b> |

Mbyllet me nr. rendor 21 (njëzet e një).



## Norma ditore e ushqimit me një vakt “Drekë” për Njësinë Speciale në Gardën e Republikës

| Nr. | Ushqimet                   | Sasia/gr | Energjia k/Cal | Proteina /gr | Yndyra /gr   | Glucide /gr   |
|-----|----------------------------|----------|----------------|--------------|--------------|---------------|
| 1   | Bukë gruri masive          | 180      | 441.00         | 18.18        | 4.14         | 88.38         |
| 2   | Oriz                       | 70       | 253.40         | 4.9          | 0.42         | 61.32         |
| 3   | Makarona                   | 70       | 249.20         | 7.56         | 0.21         | 57.96         |
| 4   | Mish viçi                  | 220      | 316.80         | 44.66        | 15.4         | 0             |
| 5   | Vaj ushqimor vegjetal      | 10       | 90.00          | 0            | 10           | 0             |
| 6   | Gjalpë i freskët           | 10       | 75.80          | 0.08         | 8.34         | 0.11          |
| 7   | Kos / Qumësht              | 200      | 98.00          | 7            | 3.6          | 10            |
| 8   | Vezë (1 kokërr mesatare)   | 60       | 93.60          | 7.8          | 6.66         | 0.6           |
| 9   | Patate                     | 90       | 76.50          | 1.89         | 0.9          | 1.62          |
| 10  | Perime për gatim e sallatë | 300      | 57.00          | 5.4          | 1.2          | 6.6           |
| 11  | Fruta                      | 250      | 112.50         | 0.5          | 0.75         | 27.5          |
| 12  | Salcë domate               | 6        | 3.00           | 0.054        | 0.024        | 0.684         |
| 13  | Kripë                      | 10       | 0.00           | 0            | 0            | 0             |
| 14  | Erëza                      | 2        | 1.32           | 0.044        | 0.04         | 0.194         |
|     | <b>Totali</b>              |          | <b>1868.12</b> | <b>98.07</b> | <b>51.68</b> | <b>254.97</b> |

Mbyllet me nr. rendor 14 (katërmbëdhjetë).

## Norma ditore e ushqimit me një vakt “Drekë” për strukturat e tjera në Gardën e Republikës

| Nr. | Ushqimet                   | Sasia/gr | Energjia k/Cal | Proteina/gr  | Yndyra/gr    | Glucide/gr    |
|-----|----------------------------|----------|----------------|--------------|--------------|---------------|
| 1   | Bukë gruri masive          | 180      | 441            | 18.18        | 4.14         | 88.38         |
| 2   | Oriz                       | 60       | 217.2          | 4.2          | 0.36         | 52.56         |
| 3   | Makarona                   | 60       | 213.6          | 6.48         | 0.18         | 49.68         |
| 4   | Mish viçi                  | 150      | 216            | 30.45        | 10.5         | 0             |
| 5   | Vaj ushqimor vegjetal      | 10       | 90             | 0            | 10           | 0             |
| 6   | Gjalpë i freskët           | 10       | 75.8           | 0.08         | 8.34         | 0.11          |
| 7   | Kos/qumësht                | 180      | 88.2           | 6.3          | 3.24         | 9             |
| 8   | Vezë (1 kokërr mesatare)   | 60       | 93.6           | 7.8          | 6.66         | 0.6           |
| 9   | Patate                     | 90       | 76.5           | 1.89         | 0.9          | 1.62          |
| 10  | Perime për gatim e sallatë | 250      | 47.5           | 4.5          | 1            | 5.5           |
| 11  | Fruta                      | 200      | 90             | 0.4          | 0.6          | 22            |
| 12  | Salcë domate               | 5        | 2.5            | 0.045        | 0.02         | 0.57          |
| 13  | Kripë                      | 10       | 0              | 0            | 0            | 0             |
| 14  | Erëza                      | 3        | 1.98           | 0.066        | 0.06         | 0.291         |
|     | <b>TOTALI</b>              |          | <b>1653.88</b> | <b>80.39</b> | <b>46.00</b> | <b>230.31</b> |

Mbyllet me nr. rendor 14 (katërmbëdhjetë).



## VENDIM

Nr. 202, datë 7.4.2023

**PËR NJË SHITESË FONDI NË  
BUXHETIN E MINISTRISË SË  
KULTURËS, PËR VITIN 2023, PËR  
FINANCIMIN E PROJEKTIT TEKNIK  
TË NDËRHYRJES EMERGJENTE NË  
OBJEKTIN, MONUMENT KULTURE,  
KATEGORIA I “URA E MATIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Ministrisë së Kulturës, në buxhetin e vitit 2023, në programin “Trashëgimia kulturore dhe muzetë”, t’i shtohet fondi prej 57 515 644 (pesëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind e pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e katër) lekësh në shpenzime kapitale, për financimin e projektit teknik të ndërhyrjes emergjente në objektin, Monument Kulture, kategoria I “Ura e Matit”.

2. Ky fond përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2023.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR  
Edi Rama**

## VENDIM

Nr. 206, datë 7.4.2023

**PËR NGRITJEN E STRUKTURAVE DHE  
AUTORITETEVE PËRGJEGJËSE PËR  
MENAXHIMIN INDIREKT DHE  
USHTRIMIN E FUNKSIONEVE, TË  
PËRGJEGJËSIVE DHE TË  
MARRËDHËNIEVE NDËRMJET  
AUTORITETEVE DHE STRUKTURAVE  
TË MENAXHIMIT INDIREKT TË  
ASISTENCËS SË BASHKIMIT  
EVROPIAN, NË KUADËR TË  
PROGRAMIT PËR ZHVILLIMIN RURAL  
TË INSTRUMENTIT PËR ASISTENCËN  
E PARAANËTARËSIMIT (IPARD III)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10 e 11, të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit IPA III, ratifikuar me ligjin nr. 65/2022, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

## I. TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për objekt krijimin e strukturave dhe autoriteteve përgjegjëse për menaxhimin indirekt dhe marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet autoriteteve dhe strukturave për të marrë detyrat e zbatimit të buxhetit (këtej e tutje “menaxhimi indirekt/MI”), për zbatimin e Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit të Bashkimit Evropian (IPA III), në kuadër të programit të zhvillimit rural (IPARD III), sipas përcaktimeve të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit, të ratifikuar me ligjin nr. 65/2022, “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të zbatimit të





Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit IPA III”, dhe të marrëveshjes sektoriale, të ratifikuar me ligjin nr. 97/2022, “Për ratifikimin, të marrëveshjes sektoriale, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, që përcakton dispozitat e menaxhimit dhe zbatimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të programit për zhvillimin rural të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPARD III)”.

2. Ky vendim siguron që, nën menaxhimin indirekt të programit IPA III, autoriteteve u ngarkohen përgjegjësi për aktivitetet, në lidhje me menaxhimin, zbatimin, kontrollin, mbikëqyrjen, monitorimin, vlerësimin, raportimin, publikimin apo auditimin e programit IPARD III.

## II. STRUKTURAT DHE AUTORITETET E MENAXHIMIT INDIREKT

1. Me qëllim menaxhimin, kontrollin, mbikëqyrjen, monitorimin, vlerësimin, raportimin, publikimin dhe auditimin e asistencës financiare të Bashkimit Evropian, në kuadër të programit për zhvillimin rural të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPARD III) 2021–2027, krijohen strukturat dhe autoritetet, si më poshtë vijon:

- a) Koordinatori Kombëtar i IPA-së (KKIPA);
- b) Zyrtari Kombëtar Autorizues (ZKA);
- c) Struktura e menaxhimit (SM), përgjegjëse para ZKA-së, e përbërë nga:
  - i. Organi kontabël (OK);
  - ii. Zyra mbështetëse e ZKA-së.
- ç) Autoriteti menaxhues dhe organi i ndërmjetëm, i përbërë nga:
  - i. Autoriteti menaxhues IPARD (AM);
  - ii. Agjencia IPARD.
- d) Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës Financiare të Bashkimit Evropian (AA).

2. Autoritetet mundësojnë ushtrimin e detyrave që shoqërojnë këtë përgjegjësi, duke përfshirë rastet ku nuk ka lidhje hierarkike ndërmjet këtyre dhe organeve pjesëmarrëse në atë aktivitet.

3. Në ushtrimin e këtyre funksioneve, ndërmjet tyre dhe organeve përkatëse, këto autoritete duhet të krijojnë:

- a) marrëdhënie formale të punës;
- b) një sistem të përshtatshëm për shkëmbimin e informacionit, duke përfshirë të drejtën për të kërkuar informacion dhe të drejtën e aksesit në dokumentacion dhe në staf, gjithashtu, edhe në terren, nëse është e nevojshme;

c) standardet që duhen përbushur dhe procedurat që duhen ndjekur.

4. Të gjitha raportet, vlerësimet dhe dokumentet e tjera, që lidhen me përgatitjen dhe zbatimin e programit të zhvillimit rural (IPARD III), të cilat i dorëzohen Komisionit Evropian (KE), hartohen në gjuhën angleze.

## III. KOORDINATORI KOMBËTAR IPA III

1. Koordinatori Kombëtar i IPA-së është drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës.

2. KKIPA-ja, si autoritet i menaxhimit të programit IPA III, është struktura homologe e Komisionit Evropian për procesin e përgjithshëm të koordinimit të programimit, monitorimit të zbatimit, vlerësimit dhe raportimit të asistencës IPA III.<sup>1</sup>

3. KKIPA-ja përcakton strukturën përgjegjëse mbështetëse në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës për zbatimin e funksioneve të saj. Rolet dhe përgjegjësitë e kësaj strukture, si dhe lidhjet me strukturat e tjera janë të përshkuara, në mënyrë të detajuar, në manualin e procedurave dhe në marrëveshjen operacionale.

4. KKIPA-ja, gjithashtu:

a) garanton lidhje të ngushtë midis përdorimit të asistencës IPA dhe procesit të përgjithshëm të anëtarësimit;

b) merr masa për të siguruar që objektivat e vendosur në programet e veprimit, për të cilët janë besuar detyrat e zbatimit të buxhetit, të jenë adresuar siç duhet gjatë zbatimit të asistencës IPARD III;

c) në zbatim të nenit 57 të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit, ratifikuar me ligjin nr. 65/2022, koordinon hartimin e një plani vlerësimi, në konsultim me Komisionin, ku paraqet aktivitetet vlerësuese, që kryhen në faza të ndryshme të zbatimit të asistencës së programeve IPA III dhe IPARD III, duke përfshirë në këtë plan edhe planin e vlerësimit të hartuar nga AM-ja, në konsultim me KKIPA-në, për programin IPARD III;

<sup>1</sup> Neni 6, pika 1, i marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit për IPA III.



ç) bën të gjitha përpjekjet që administrata shtetërore të marrë masat e duhura për të lehtësuar zbatimin e programeve përkatëse;

d) siguron që objektivat e vendosur në veprimet apo programet e propozuara nga administrata shtetërore të jenë në koherencë me objektivat e përcaktuar në Dokumentin Kombëtar Strategjik;

dh) merr masat për të siguruar pronësinë e programimit dhe implementimit të asistencës së IPARD III nga qeveria shqiptare;

e) merr pjesë, pa të drejtë vote, në Komitetin Monitorues IPARD III;

ë) i paraqet Komisionit raportet vjetore dhe ato finale implementuese, të hartuara nga AM-ja dhe të miratuara nga Komiteti Monitorues IPARD III, duke vënë në dijeni edhe ZKA-në dhe AA-në;

f) konfirmon, së bashku me ZKA-në dhe titullarin e autoritetit auditues, gatishmërinë për të realizuar funksionet dhe përgjegjësitë që u janë ngarkuar, sipas shtojcës A të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit;

g) brenda datës 15 shkurt, të vitit financiar pasardhës, i dorëzon Komisionit një raport vjetor mbi zbatimin e asistencës IPA III, programit IPARD III dhe detyrave të besuara për zbatimin e buxhetit, sipas neneve 59 e 60 të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit për IPA III.

#### IV. ZYRTARI KOMBËTAR AUTORIZUES (ZKA)

1. Zyrtari Kombëtar Autorizues është zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë.

2. ZKA-ja është përgjegjës për menaxhimin financiar të asistencës së IPA III dhe IPARD III në Shqipëri dhe për ligjshmërinë e rregullsinë e shpenzimeve.

3. Në fushën e menaxhimit financiar, ZKA-ja kryen këto detyra:

a) Ngre një sistem kontabël aktual për regjistrimin dhe ruajtjen në format elektronik të të dhënave kontabël të sakta, të plota dhe të besueshme për programin IPARD III që zbatohet me menaxhim indirekt nga Shqipëria;

b) Organizon dhe menaxhon sistemin e llogarive në euro;

c) Dërgon pranë Komisionit kërkesëpagesat për programin IPARD III;

ç) Garanton ekzistencën, korrektësinë dhe disponueshmërinë e elementeve të bashkë-financimit;

d) Përcjell pranë Agjencisë IPARD fondet që merr nga Komisioni dhe bashkëfinancimi publik për menaxhim financiar për transferim të mëtejshëm të marrësit e asistencës së IPARD III;

dh) Garanton ekzistencën dhe disponueshmërinë e burimeve të mjaftueshme për të përballuar mungesat e mundshme, për shkak të transferimit me vonesë të fondeve nga Komisioni ose urdhrave të rikuperimit që nxjerr Komisioni.

4. ZKA-ja ka përgjegjësinë e plotë për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit të IPA III dhe IPARD III në Shqipëri:

a) duke aplikuar dhe dorëzuar pranë Komisionit kërkesën për të marrë detyrat e zbatimit të buxhetit, në kuadrin e një programi apo mase të caktuara, në përputhje me nenet 13(1) dhe 13(2), të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit, ratifikuar me ligjin nr. 65/2022, dhe nenit 26 të marrëveshjes sektoriale, të ratifikuar me ligjin nr. 97/2022;

b) duke monitoruar përmbushjen në vijimësi nga ana e strukturave dhe autoriteteve të kërkesave të neneve 12(2) dhe 12(3) dhe të shtojcës B të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit, ratifikuar me ligjin nr. 65/2022, dhe të shtojcës B të marrëveshjes sektoriale, ratifikuar me ligjin nr. 97/2022, si dhe informon Komisionin, duke vënë në dijeni KKIPA-në dhe autoritetin auditues për çdo mospërmbushje të këtyre kërkesave;

c) duke vendosur masat efektive dhe antimashtrim, duke marrë parasysh risqet e identifikuar;

ç) duke marrë parasysh rezultatet e të gjitha verifikimeve dhe auditeve të jashtme lidhur me sistemin e menaxhimit dhe kontrollit IPARD III, përfshirë ato të kryera nga autoriteti auditues, Komisioni apo Gjykata Evropiane e Llogarive, si dhe duke koordinuar përgatitjen dhe zbatimin e planeve përkatëse të veprimit, me qëllim përmirësimin e përputhshmërisë dhe efektivitetit të sistemit të menaxhimit dhe kontrollit IPARD III;

d) duke vendosur dhe miratuar rregullat e procedurat, nëpërmjet marrëveshjes zbatuese dhe operacionale me KKIPA-në, autoritetin menaxhues IPARD dhe agjencinë IPARD.

5. ZKA-ja harton dhe dorëzon, pranë Komisionit, duke vënë në dijeni KKIPA-në dhe autoritetin auditues, deri në 15 shkurt të vitit financiar pasardhës, dokumentacionin, sipas kërkesave të parashikuara në pikën 2, të nenit 61, të



marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit.

6. ZKA-ja vepron si bashkëbiseduesi i vetëm me KE-në për të gjitha çështjet mbi IPARD III, sipas përcaktimeve të nenit 7 të marrëveshjes sektoriale.

7. ZKA-ja bashkëpunon me strukturën e inspektimit financiar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, që vepron si Njësia e Shërbimit të Koordinimit Kundër Mashtrimit (AFCOS), me qëllim parandalimin, zbulimin, raportimin, investigimin dhe ndjekjen e parregullsisve. Marrëdhëniet e ndërsjella rregullohen me memorandumet e bashkëpunimit, ndërmjet ZKA-së dhe strukturës së inspektimit financiar (AFCOS) dhe ndërmjet ZKA-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme të Shqipërisë.

8. Garanton hetim dhe trajtim efektiv të rasteve të dyshuara për parregullsi, mashtrim, korrupsion dhe konflikt interesi gjatë zbatimit, si dhe funksionimin e një mekanizmi kontrolli dhe raportimi për to, në përputhje me nenin 51(2), (3) dhe (4) të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit.

9. ZKA-ja miraton manualin e procedurave për strukturën menaxhuese dhe zbatuese dhe marrëveshjet ndërmjet autoriteteve.

10. ZKA-ja vlerëson çdo ndryshim të propozuar në procedurat e autoritetit menaxhues IPARD/Agjencisë IPARD dhe SM-së, për zbatimin apo kryerjen e pagesave. ZKA-ja informon KE-në, duke vënë në dijeni edhe AA-në për çdo ndryshim thelbësor, duke përfshirë edhe vlerësimin e tij, shpjegimet e duhura, arsyetimet dhe dokumentet mbështetëse të nevojshme për shqyrtim e miratim paraprak për zbatimin e ndryshimeve.

#### V. STRUKTURA MENAXHUESE

1. Struktura menaxhuese përbëhet nga organi kontabël dhe zyra mbështetëse e ZKA-së, struktura të veçanta në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, nën përgjegjësinë e ZKA-së për zbatimin e programit IPARD III, me një ndarje të qartë të detyrave, siç përshkruhet në këtë vendim, në manualin e tyre të procedurave dhe rregulloren e brendshme të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Organi kontabël është strukturë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, që ka kompetenca qendrore buxhetore dhe vepron si subjekt qendror i thesarit. Ai mbështet ZKA-në në përmbushjen e

detyrave të tij/saj, në veçanti, ato të menaxhimit të llogarive të IPA III dhe IPARD III, dhe në operacionet financiare, dhe është përgjegjës për detyrat e menaxhimit financiar të asistencës IPARD III, nën përgjegjësinë e ZKA-së.

3. Organi kontabël mbështet ZKA-në në realizimin e detyrave në përputhje me shtojcën A, klauzola 4(3) dhe nenin 61(5), të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit. Organi kontabël është veçanërisht përgjegjës, për:

a) hapjen dhe organizimin e llogarive bankare të IPARD III;

b) kërkimin e fondeve dhe marrjen e të gjitha pagesave nga buxheti i BE-së;

c) kërkimin e fondeve dhe marrjen e të gjitha pagesave nga buxheti i shtetit, për elementet e bashkëfinancimit, sipas rastit;

ç) autorizimin dhe transferimin e këtyre pagesave tek Agjencia IPARD ose të marrësit;

d) kthimin e fondeve në buxhetin e BE-së, pas lëshimit të urdhrave të kthimit nga Komisioni;

dh) mbështetjen e ZKA-së në përgatitjen e raportimit financiar për Komisionin dhe mbajtjen e një sistemi kontabël kompjuterik, që jep informacion të saktë, të plotë, të besueshëm dhe në kohën e duhur.

4. Gjatë përmbushjes së përgjegjësisë të tij lidhur me menaxhimin financiar të IPA III, organi kontabël bashkëpunon me Bankën e Shqipërisë, bazuar në një marrëveshje të posaçme, që rregullon afatet dhe kushtet për funksionimin e llogarive në monedhën vendëse dhe të huaj, të hapura me Bankën e Shqipërisë.

5. Kur është e nevojshme, organi kontabël kryen verifikime në vend, për të siguruar menaxhim efektiv dhe efikas financiar të llogarive IPARD III dhe të operacioneve financiare.

6. Zyra mbështetëse e ZKA-së është strukturë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, nën përgjegjësinë dhe në raportim direkt me ZKA-në, në mbështetje të përmbushjes së përgjegjësisë të tij/saj për funksionimin efektiv të menaxhimit dhe të sistemeve të kontrollit të brendshëm, për zbatimin e asistencës së programit IPARD III.

7. Zyra mbështetëse e ZKA-së mbështet ZKA-në në realizimin e detyrave, në përputhje me shtojcën A, klauzolën 4(2) të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit. Zyra mbështetëse e ZKA-së është veçanërisht përgjegjëse, për:



a) garantimin dhe sigurimin e ZKA-së për ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve themeltare;

b) vendosjen e masave efikase dhe antimashttrim, duke marrë parasysh risqet e identifikuar, garantimin e raportimit, sipas dispozitave të pikës 2, të nenit 51, të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit, të ratifikuar me ligjin nr. 65/2022, duke koordinuar me shërbimet e strukturës së inspektimit financiar (AFCOS) dhe duke informuar në lidhje me këtë raportim;

c) monitorimin dhe përmbushjen në vijimësi nga struktura menaxhuese dhe autoriteti menaxhues IPARD e agjencia IPARD të kërkesave të neneve 12(2) dhe 12(3) dhe shtojcës B, të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit, për informimin pa vonesë të Komisionit, në rast mosplotësimi të tyre, si dhe për marrjen e masave mbrojtëse, të përshtatshme, në lidhje me pagesat e kryera ose kontratat e nënshkruara;

ç) ngritjen dhe sigurimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm efektiv dhe efikas, duke marrë parasysh:

- i. mjedisin e kontrollit;
- ii. menaxhimin e riskut;
- iii. aktivitetet e kontrollit;
- iv. informimin dhe komunikimin;

v. monitorimin e kuadrit të kontrollit të brendshëm;

d) sigurimin e raportimit mbi sistemet e menaxhimit e kontrollit dhe vlerësimin e kapaciteteve të stafit për programim e zbatim në strukturat menaxhuese dhe operative, të përfshira në procedurat e programimit dhe zbatimit;

dh) sigurimin e funksionimit të një sistemi të përshtatshëm raportimi dhe informimi;

e) ndjekjen e konstatimeve dhe rekomandimeve të raporteve të auditit, të kryera nga Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës së Bashkimit Evropian, dhe sigurimin e informacionit të vazhdueshëm për ZKA-në, me qëllim marrjen e vendimeve;

ë) mbajtjen parasysh, gjatë përgatitjes së deklaratës vjetore të menaxhimit, siç parashikohet në shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 61, të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit, të ratifikuar me ligjin nr. 65/2022, të rezultateve të auditeve të kryera nga/nën përgjegjësini e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës së Bashkimit Evropian;

f) njoftimin menjëherë, pranë Komisionit, për ndonjë ndryshim thelbësor, në lidhje me sistemet e menaxhimit dhe të kontrollit për shqyrtimin e miratimit paraprak të zbatimit të tyre;

g) bashkërendimin e aktiviteteve të IPARD III, për llogari të ZKA-së dhe, kur është e nevojshme, përgatitjen e planeve të veprimit të konsoliduara, duke adresuar dobësitë e identifikuar në sistemet e menaxhimit dhe kontrollit;

gj) në përputhje me planin vjetor të vizitave verifikuese e menaxheriale, kur është e nevojshme, kryerjen e verifikimeve në vend, për të siguruar funksionimin efektiv të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm.

8. Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës Financiare nga Bashkimi Evropian është një strukturë e pavarur, funksionale dhe financiare, nga strukturat dhe autoritetet e cituara në pikën 2, të këtij vendimi. Funksionet dhe përgjegjësitë e saj përcaktohen me ligj dhe me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### VI. STRUKTURAT PËR PROGRAMET E ZHVILLIMIT RURAL

1. Autoriteti menaxhues IPARD dhe agjencia IPARD janë strukturat për programet e zhvillimit rural, të pavarura nga njëra-tjetra, por që funksionojnë në bashkëpunim të ngushtë.

2. Detyrat specifike të autoritetit menaxhues IPARD dhe agjencisë IPARD përcaktohen në krerët VII dhe VIII të këtij vendimi dhe rregullohen me një marrëveshje operationale ndërmjet tyre.

#### VII. AUTORITETI MENAXHUES IPARD

1. Autoriteti menaxhues IPARD është strukturë në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, përgjegjëse për përgatitjen dhe zbatimin e programeve, përfshirë përzgjedhjen e masave dhe publicitetin, koordinimin, vlerësimin, monitorimin e raportimin e programit IPARD III.

2. Autoriteti menaxhues IPARD kryen funksionet, duke siguruar zbatim efektiv të programit IPARD III, për:

a) përgatitjen e programit IPARD III dhe të ndryshimeve të mundshme të tij, përfshirë ato që kërkohen nga Komisioni;

b) kontrollin dhe verifikimin e masave që përcaktohen në programin IPARD III, në bashkëpunim me agjencinë IPARD;

c) përzgjedhjen e masave, nën secilën thirrje për aplikim, në kuadrin e programit IPARD III, kohën



e zbatimit, kushtet e pranimit dhe shpërndarjen financiare për çdo masë, nën çdo thirrje. Vendimet merren bashkërisht me agjencinë IPARD;

ç) miratimin e bazës ligjore kombëtare të përshtatshme për zbatimin e IPARD III, si dhe rishikimin e saj, sipas nevojës;

d) mbështetjen e Komitetit Monitorues IPARD III, kryesisht duke ofruar dokumentet e nevojshme për monitorimin e cilësisë dhe zbatimit të programit IPARD III.

3. Autoriteti menaxhues IPARD ngre një sistem raportimi dhe informimi për mbledhjen e informacionit financiar dhe statistikor mbi progresin e programit IPARD III, bazuar edhe në informacionin që merr nga agjencia IPARD. Këto të dhëna AM-ja ia përcjell Komitetit Monitorues IPARD III, sipas modaliteteve të rëna dakord ndërmjet Shqipërisë dhe Komisionit, duke përdorur, ku është e mundur, sisteme kompjuterike që mundësojnë shkëmbim të dhënash me të dhe të lidhura me sistemin e raportimit e informacionit të ngritur nga ZKA-ja, në përputhje me pikën 4, të klauzolës 6a, të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit.

4. Autoriteti menaxhues IPARD i propozon Komisionit ndryshime në programin IPARD III, duke vënë në dijeni edhe Koordinatorin Kombëtar IPA, pas konsultimit me agjencinë IPARD dhe pasi ka marrë pëlqimin e Komitetit Monitorues IPARD III. Autoriteti menaxhues IPARD është përgjegjës për informimin e autoriteteve përkatëse mbi nevojën e ndryshimeve administrative, kur këto ndryshime kërkohen pas një vendimi të Komisionit që ndryshon programin IPARD III.

5. Autoriteti menaxhues IPARD harton çdo vit një plan veprimi për operacionet që synohen të realizohen me asistencën teknike, i cili i dorëzohet Komitetit Monitorues IPARD III për miratim.

6. Autoriteti menaxhues IPARD harton një plan vlerësimi, i cili i dorëzohet Komitetit Monitorues, jo më vonë se një vit pas miratimit të programit IPARD III nga Komisioni. Autoriteti menaxhues IPARD raporton te Komiteti Monitorues IPARD III dhe te Komisioni mbi progresin e bërë me zbatimin e këtij plani.

7. Autoriteti menaxhues IPARD harton një plan koherent me aktivitetet për vizibilitetin dhe komunikimin, si dhe konsultohet e informon Komisionin, pasi është këshilluar me Komitetin Monitorues IPARD III. Plani, mbi të gjitha, tregon

nismat e ndërmarra dhe që do të ndërmerren për informimin e publikut për rolin e luajtur nga BE-ja e programi IPARD III dhe për rezultatet e tij.

8. Nëse autoriteti menaxhues IPARD delegon një pjesë të detyrave të një organ tjetër, ai mban përgjegjësinë e plotë për menaxhimin dhe zbatimin e atyre detyrave, në përputhje me parimin e menaxhimit të shëndoshë financiar.

9. Autoriteti menaxhues IPARD siguron që të gjitha informacionet përkatëse në lidhje me ecurinë e masave t'i vihen në dispozicion Komitetit Monitorues të programit IPARD III dhe KKIPA-së.

#### VIII. AGJENCIA IPARD

1. Agjencia IPARD është një agjenci e pavarur, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, përgjegjëse për zbatimin e programit IPARD III, raportimin, autorizimin dhe kontrollin e detyrimeve financiare, autorizimin dhe kontrollin e pagesave, ekzekutimin e pagesave, kontabilizimin e detyrimeve dhe pagesave, menaxhimin e borxhit, thesarin, përzgjedhjen e projekteve, publicitetin dhe auditimin e brendshëm.

2. Agjencia IPARD është përgjegjëse, për:

a) dhënien e konfirmimit autoritetit menaxhues për kontrollin dhe verifikimin e masave të programit IPARD III;

b) organizimin e thirrjeve për aplikime dhe publikimin e kushteve e të pranueshmërisë, pasi merr pëlqimin e autoritetit menaxhues IPARD lidhur me çështjet e ngritura në klauzolat 6a(3)(c) të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit;

c) përzgjedhjen e projekteve për zbatim;

ç) përcaktimin me shkrim të detyrimeve kontraktuale, ndërmjet agjencisë IPARD dhe përfituesve, përfshirë informacionin për sanksionet e mundshme, në rast mospërbushjeje të detyrave dhe, sipas rastit, lëshimin e miratimit për nisjen e punës. Agjencia IPARD mund të vazhdojë të kontrakttojë apo të marrë përsipër zotime, në zbatim të kësaj marrëveshjeje për një masë specifike, deri në datën kur Shqipëria fillon të kontrakttojë apo të marrë përsipër zotime për këtë masë, në kuadrin e ndonjë programi pasues të IPARD III;

d) marrjen e masave ndjekëse për të garantuar progresin e projekteve në zbatim;

dh) raportimin mbi progresin e masave në zbatim, kundrejt disa indikatorëve;



e) garantimin që përfituesi të sensibilizohet për kontributin e BE-së në projekt;

ë) garantimin për raportimin e parregullsisve, në nivel kombëtar;

f) garantimin që ZKA-ja, struktura menaxhuese dhe autoriteti menaxhues IPARD të marrin të gjithë informacionin që u nevojitet për kryerjen e detyrave të tyre;

g) garantimin e respektimit të detyrimeve në lidhje me publicitetin, sipas nenit 23, të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit.

3. Për investime në projekte infrastrukturore, që priten të gjenerojnë të ardhura neto të konsiderueshme, agjencia IPARD vlerëson nëse ky projekt është i këtij tipi para se të hyjë në marrëdhënie kontraktuale me një përfitues potencial. Nëse konstatohet se ai është i tillë, agjencia IPARD sigurohet që ndihma publike nga të gjitha burimet nuk tejkalon masën 50% të koston totale të lidhur me projektin dhe të konsideruar të pranueshme për bashkëfinancim të BE-së.

4. Agjencia IPARD siguron që për çdo projekt të programit IPARD III, akumulimi i ndihmës publike, të dhënë nga të gjitha burimet, të mos tejkalojë tavanet maksimale për shpenzimet publike, të përcaktuara në shtojcën 4, të marrëveshjes sektoriale.

#### IX. KOMITETI I MONITORIMIT PËR PROGRAMIN IPARD III

1. Autoriteti menaxhues dhe Komiteti i Monitorimit të programit IPARD III (këtu e në vijim “Komiteti i Monitorimit”) monitoron efektivitetin dhe cilësinë e zbatimit të programit IPARD III.

2. Komiteti i Monitorimit themelohet pas miratimit të programit dhe kryesohet nga një përfaqësues i lartë i Shqipërisë, i cili ka të drejtë vote dhe raporton pranë Komitetit Monitorues të IPA III dhe KE-së për progresin e masave.

3. Komisioni, autoriteti menaxhues IPARD/Agjencia IPARD, ZKA-ja dhe KKIPA-ja marrin pjesë, pa të drejtë vote, në punën e Komitetit Monitorues IPARD III. Me qëllim zbatimin e pikës 1, të nenit 53, të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit, Komiteti i Monitorimit shqyrton rezultatet e programit IPARD III, në veçanti arritjen e objektivave të përcaktuar për masat e ndryshme dhe ecurinë e alokimeve financiare ndaj këtyre masave. Në këtë drejtim, autoriteti menaxhues IPARD garanton që i

gjithë informacioni lidhur me ecurinë e masave t'i vihet në dispozicion Komitetit Monitorues dhe KKIPA-së.

4. Komiteti i Monitorimit shqyrton, periodikisht, progresin e bërë drejt arritjes së objektivave të përcaktuar në programin IPARD III. Për këtë qëllim, Komitetit duhet t'i vihen në dispozicion, veçanërisht, informacioni për çdo sektor ose masë, ku janë hasur vështirësi, si dhe mbi rezultatet e verifikimeve të realizuara.

5. Komiteti i Monitorimit duhet të marrë në konsideratë dhe të miratojë, kur është e përshtatshme, çdo propozim për ndryshim të programit IPARD III, të hartuar nga AM-a, për t'iu dërguar KE-së dhe, për dijeni, KKIPA-së e ZKA-së.

6. Komiteti i Monitorimit, pas konsultimit me autoritetin menaxhues IPARD dhe agjencinë IPARD, i propozon autoritetit menaxhues IPARD, duke vënë në dijeni ZKA-në dhe KKIPA-në, ndryshime për programin IPARD III, me qëllim arritjen e objektivave dhe rritjen e asistencës së dhënë.

7. Komiteti i Monitorimit shqyrton dhe miraton raportet vjetore e përfundimtare të zbatimit, përpara se ato të dërgohen pranë KKIPA-së për dorëzimin në KE, me një kopje për ZKA-në dhe autoritetin auditues.

8. Komiteti i Monitorimit shqyrton vlerësimet e programit IPARD III, referuar nenit 56 të marrëveshjes sektoriale.

9. Komiteti i Monitorimit shqyrton dhe miraton planin me aktivitetet e vizibilitetit dhe komunikimit, të përcaktuara në nenin 32 të marrëveshjes sektoriale, si dhe çdo përditësim të mëvonshëm të tij.

10. Për aktivitetet e asistencës teknike, në kuadrin e programit IPARD III, merret mendimi i Komitetit të Monitorimit. Ai shqyrton dhe miraton çdo vit një plan veprimi vjetor, tregues për zbatimin e aktiviteteve të asistencës teknike, bashkë me shumat indikative, për qëllime informimi.

11. Komiteti i Monitorimit vepron në përputhje me rrethanat, nëse nga programi IPARD III i kërkohet të japë mendim për ndonjë çështje.

12. Të gjitha dokumentet përfundimtare të mbledhjeve të Komitetit të Monitorimit bëhen publike.



## X. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
Edi Rama

MINISTËR I DREJTËSISË  
Ulsi Manja

## URDHËR

Nr. 243, datë 31.3.2023

**PËR MIRATIMIN E MODELIT TË KONTRATËS QË LIDHET MIDIS PËRMBARUESIT GJYQËSOR PRIVAT DHE PALËS SË INTERESUAR PËR KRYERJEN E KONSTATIMEVE TË FAKTEVE, SENDEVE DHE DUKURIVE LEHTËSISHT TË VERIFIKUESHME, QË NUK KËRKOJNË NJOHURI SPECIFIKE TEKNIKE, SIPAS LEGJISLACIONIT NË FUQI**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës; të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 14, shkronja “gj”, të ligjit nr. 26/2019, “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”,

## URDHËROJ:

1. Miratimin e modelit të kontratës që lidhet midis përmbartuesit gjyqësor privat dhe palës së interesuar për kryerjen e konstatimeve të fakteve, sendeve dhe dukurive lehtësisht të verifikueshme, që nuk kërkojnë njohuri specifike teknike, sipas legjislacionit në fuqi, sipas tekstit të shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Marrëdhëniet kontraktore ndërmjet zyrës së përmbartimit privat ose përmbartuesit gjyqësor privat dhe palës së interesuar rregullohen sipas legjislacionit në fuqi dhe përcaktimeve të të drejtave dhe detyrimeve të parashikuara në kontratën e shërbimit.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë, zyrat e përmbartimit privat, përmbartuesit gjyqësorë privatë,

si dhe Dhoma Kombëtare e Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë, për ndjekjen dhe zbatimin këtij urdhri.

4. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

## SHTOJCA NR. 1

**KONTRATË SHËRBIMI PËR KRYERJEN E KONSTATIMIT TË FAKTEVE, SENDEVE DHE DUKURIVE LEHTËSISHT TË VERIFIKUESHME, QË NUK KËRKOJNË NJOHURI SPECIFIKE TEKNIKE SIPAS LEGJISLACIONIT NË FUQI,**

Sot, më datë \_\_\_\_\_, në zyrën e përmbartimit privat/përmbartuesit gjyqësor privat “\_\_\_\_\_”

lidhet kjo kontratë shërbimi midis:

**A. Zyrës së përmbartimit privat/përmbartuesit gjyqësor privat \_\_\_\_\_**  
me nr. licence \_\_\_\_\_, NUIS \_\_\_\_\_, me adresë postare \_\_\_\_\_; adresë elektronike, \_\_\_\_\_;

dhe

**B. Palës së interesuar/kërkuesit të shërbimit**  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

*(Për subjektin fizik jepën: emri, atësia, mbiemri, numri i dokumentit të identifikimit, adresa, adresa elektronike; ndërsa për personin juridik jepën: emri, NUIS-i, selia, adresa elektronike, si dhe emri, atësia, mbiemri dhe numri i dokumentit të identifikimit të përfaqësuesit ligjor.)*

**Baza ligjore**

Hartimi dhe zbatimi i kësaj kontrate bazohet në dispozitat e përgjithshme që parashikohen në Kodin Civil për kontratën e porosisë, për aq sa



kanë kuptim, si dhe në ligjin nr. 26/2019, “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”.

Palët e mësipërme bien dakord të lidhin midis tyre kontratën si më poshtë vijon:

#### Neni 1

##### **Objekti i kontratës**

Kryerja e të gjitha veprimeve të ligjshme për konstatimin e faktit/sendit/dukurisë të përshkruara në kërkesën e të interesuarit drejtuar zyrës së përmbartimit privat/përmbartuesit gjyqësor privat, që konsistojnë në konstatimin e faktit/ sendit/ dukurisë \_\_\_\_\_

(përshkruhet shkurtimisht kërkesa e kërkuesi/palës së interesuar).

#### Neni 2

##### **Të drejtat e kërkuetit/palës së interesuar**

Kërkueti/pala e interesuar, ka të drejtë:

1. Të kërkojë informacion nga zyra e përmbartimit privat/përmbartuesi gjyqësor privat nëpërmjet kërkesës me shkrim, lidhur me veprimtarinë për përmbushjen e objektit të kësaj kontrate.

2. Të marrë pjesë aktive përmes dhënies dhe vënies në dijeni të përmbartuesit rreth të dhënave informuese, në kuadër të ofrimit të shërbimit të kërkuar sipas kësaj kontrate.

3. Të heqë dorë nga kërkesa për marrjen e shërbimit, përpara se përmbartuesi gjyqësor privat të ketë filluar mbajtjen e procesverbalit të konstatimit.

4. Të kërkojë kthimin e dokumentacionit dhe çdo sendi tjetër, që ka shoqëruar kërkesën për konstatimin e faktit, kur ka hequr dorë nga marrja e shërbimit.

#### Neni 3

##### **Detyrimet e kërkuetit/palës së interesuar**

Kërkueti/pala e interesuar merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

1. Në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate, të paguajë tarifën e plotë të shërbimit për kryerjen e veprimeve të konstatimit në llogarinë e zyrës së

përmbartimit privat/përmbartuesit gjyqësor privat sipas udhëzimit të ministrit të Drejtësisë “Për caktimin e tarifave të veprimtarisë dytësore të përmbartuesit gjyqësor privat për kryerjen e konstatimeve të fakteve, sendeve dhe dukurive lehtësisht të verifikueshme, që nuk kërkojnë njohuri specifike teknike, sipas legjislacionit në fuqi”.

2. Të japë të gjithë informacionin dhe dokumentet që do të kërkohen dhe ndihmojnë përmbartuesin gjyqësor privat për përmbushjen e objektit të kësaj kontrate.

3. Të japë të drejtë përmbartuesit të kryejë veprimet e nevojshme për konstatimin e faktit/sendit/dukurisë, të përcaktuara në nenin 1, të kësaj kontrate.

4. Të mos kryejë asnjë veprim që pengon përmbushjen e objektit të kësaj kontrate, si dhe të kryejë të gjitha veprimet e tjera të nevojshme, në rast se i kërkohet nga ana e përmbartuesit gjyqësor privat, për përmbushjen e objektit të kësaj kontrate.

5. Të njoftojë përmbartuesin për çdo informacion që ndikon në cenimin apo pengimin e procesit të konstatimit të faktit/sendit/dukurisë menjëherë, por jo më vonë se 24 orë nga marrja dijeni mbi cenimin.

6. Të njoftojë me shkrim zyrën e përmbartimit privat/përmbartuesin gjyqësor privat për heqjen dorë nga veprimet për konstatimin e faktit/sendit/dukurisë.

7. Të nënshkruajë procesverbalet që dokumentojnë veprimet e kryera nga ana e përmbartuesit gjyqësor privat, që shërbejnë dhe pasqyrojnë realitetin, si dhe ka të drejtën e shënimit të pretendimeve /ose vërejtjeve lidhur me procesin konstatues.

8. Të sillet në kushtet e mirëbesimit dhe të mbajë marrëdhënie të mira dhe korrekte me përmbartuesin gjyqësor privat.

#### Neni 4

##### **Të drejtat e zyrës së përmbartimit privat/përmbartuesit gjyqësor privat**

Zyra e përmbartimit privat/përmbartuesit gjyqësor privat ka të drejtë:

1. Të verifikojë paraprakisht nëse objekti i kërkesës është në përputhje me udhëzimin e ministrit të Drejtësisë “Për caktimin e tarifave të veprimtarisë dytësore të përmbartuesit gjyqësor





privat për kryerjen e konstatimeve të fakteve, sendeve dhe dukurive lehtësisht të verifikueshme, që nuk kërkojnë njohuri specifike teknike, sipas legjislacionit në fuqi”.

2. Të kërkojë parapagimin e tarifës së shërbimit të përlogaritur në përputhje me udhëzimin e ministrit të Drejtësisë “Për caktimin e tarifave të veprimtarisë dytësore të përmbuesit gjyqësor privat për kryerjen e konstatimeve të fakteve, sendeve dhe dukurive lehtësisht të verifikueshme, që nuk kërkojnë njohuri specifike teknike, sipas legjislacionit në fuqi”.

3. Të mos fillojë apo të ndërpresë menjëherë kryerjen e veprimeve konstatuese, kur kërkuesi/pala e interesuar nuk përmbush detyrimet e përcaktuara në këtë kontratë për pagimin e tarifave.

4. Të mbajë shumën e plotë të tarifës së shërbimit, në rastin kur kërkuesi/pala e interesuar, heq dorë nga kërkesa për marrjen e shërbimit, pasi ka filluar procesi i konstatimit.

#### Neni 5

##### **Detyrimet e zyrës së përbarimit privat/përmbuesit gjyqësor privat**

Zyra e përbarimit privat/përmbuesi gjyqësor privat merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

1. Të kryejë të gjitha veprimet e duhura ligjore për përmbushjen e objektit të kësaj kontrate.

2. Të informojë kërkuesin/palën e interesuar lidhur me veprimtarinë për përmbushjen e objektit të kësaj kontrate.

3. Të kthejë pagesën e plotë të tarifës së shërbimit, në rast se zyra e përbarimit privat/përmbuesi gjyqësor privat zgjidh në mënyrë të njëanshme kontratën e shërbimit.

4. Të kthejë dokumentacionin e plotë që shoqëron kërkesën e palës së interesuar, në rastin e zgjidhjes së kontratës ose heqjes dorë nga kërkesa për marrjen e shërbimit.

5. Të mos publikojë të dhëna të palës së interesuar apo çdo personi tjetër të përfshirë në procesin e konstatimit pa pëlqimin paraprak të tyre, si dhe të ruajë konfidencialitetin e informacionit të siguruar gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji.

6. Të pasqyrojë me korrektësi realitetin në hartimin e procesverbaleve dokumentuese të

veprimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke pasqyruar në to edhe pretendimet ose vërejtjet eventuale të palës së interesuar ose të pranishmëve.

7. Të silltet në kushtet e mirëbesimit dhe të mbajë marrëdhënie të mira dhe korrekte me kërkuesin/palën e interesuar.

#### Neni 6

##### **Kryerja e pagesave të shërbimit**

1. Pagesa e tarifave të shërbimit kryhet nëpërmjet derdhjes në llogarinë bankare të zyrës së përbarimit privat/përmbuesit gjyqësor privat pranë “\_\_\_\_\_”, me numër llogarie \_\_\_\_\_ dhe IBAN \_\_\_\_\_.

2. Vlera e tarifës së shërbimit që paguhet në momentin e dorëzimit të kërkesës për konstatimin e faktit është në masën \_\_\_\_\_ dhe paguhet nga kërkuesi/pala e interesuar në momentin e nënshkrimit të kontratës së shërbimit.

3. Kërkuesi/pala e interesuar duhet të vërtetojë kryerjen e pagesës nëpërmjet paraqitjes së mandatpagesës pranë zyrës së përbarimit privat/përmbuesit gjyqësor privat.

4. Me përjashtim të rasteve kur palët arrijnë në marrëveshje për të kundërtën, kërkuesi/pala e interesuar është i detyruar të paguajë edhe shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit që duhet të ndërmarrë përmbuesi për kryerjen e konstatimit.

#### Neni 7

##### **Moskryerja e pagesave të shërbimit dhe/ose shpenzimeve**

Në rast se kërkuesi/pala e interesuar nuk kryen pagesën e tarifës sipas kësaj kontrate dhe sipas udhëzimit të ministrit të Drejtësisë “Për caktimin e tarifave të veprimtarisë dytësore të përmbuesit gjyqësor privat për kryerjen e konstatimeve të fakteve, sendeve dhe dukurive lehtësisht të verifikueshme, që nuk kërkojnë njohuri specifike teknike, sipas legjislacionit në fuqi”, zyra e përbarimit privat/përmbuesi gjyqësor privat zgjidh menjëherë dhe në mënyrë të njëanshme kontratën.



## Neni 8

**Pezullimi i kontratës**

1. Zyra e përmbarimit privat/përmbaruesi gjyqësor privat nuk mban përgjegjësi, nëse mospërbushja e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i kësaj kontrate, ka ardhur për arsye të forcës madhore, rastit fator, apo veprimeve nga autoritetet ligjzbatuese shtetërore.

2. Gjatë periudhës së forcës madhore apo rastit fator, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo kontratë, pezullohen.

## Neni 9

**Rastet e zgjidhjes së kontratës**

1. Kontrata quhet e zgjidhur njëanshmërisht nga kërkuesi/pala e interesuar, kur:

a) nuk paraqitet ose refuzon të kryejë veprimet e kërkuara nga ana e përmbaruesit për të mundësuar ofrimin e shërbimit të kontraktuar;

b) nuk paguan tarifat sipas kësaj kontrate dhe sipas udhëzimit të ministrit të Drejtësisë “Për caktimin e tarifave të veprimtarisë dytësore të përmbaruesit gjyqësor privat për kryerjen e konstatimeve të fakteve, sendeve dhe dukurive lehtësisht të verifikueshme, që nuk kërkojnë njohuri specifike teknike, sipas legjislacionit në fuqi”;

c) heq dorë nga kërkesa për marrjen e shërbimit pasi ka filluar procesi i konstatimit.

2. Kontrata quhet e zgjidhur njëanshmërisht nga përmbaruesi gjyqësor privat, kur:

a) përmbaruesi gjyqësor privat e ka të pamundur të kryejë detyrën për arsye shëndetësore për një periudhë më shumë se 30 ditë pa ndërprerje;

b) përmbaruesi gjyqësor privat, për arsye studimore, e ka të pamundur të kryejë detyrën e tij për një periudhë mungese më shumë se 30 ditë pa ndërprerje;

c) përmbaruesit i hiqet ose pezullohet licenca e ushtrimit të profesionit;

ç) në rast të falimentimit të zyrës së përmbarimit privat/përmbaruesit gjyqësor privat.

3. Kontrata quhet e zgjidhur me vullnet dypalësh, kur palët bien dakord me akt të shkruar që marrëdhënia të ndërpritet pa asnjë shpërbim.

## Neni 10

**Pasojat e zgjidhjes së kontratës**

Në rastin e zgjidhjes së kontratës:

a) sipas pikës 1, të nenit 10, kërkuesi/pala e interesuar mund të tërheqë dokumentacionin që shoqëron kërkesën, por nuk rimbursohet për shumën e paguar;

b) sipas pikës 2, të nenit 10, përmbaruesi kthen menjëherë dokumentacionin që shoqëron kërkesën dhe mban përgjegjësi sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

## Neni 11

**Njoftimi midis palëve**

1. Me përjashtim të rastit kur palët bien dakord për të zgjedhur një formë tjetër komunikimi dhe njoftimi, çdo njoftim mes palëve sipas kontratës, duhet të bëhet me shkrim në adresën e mëposhtme:

a) Kërkuesi/pala e interesuar \_\_\_\_\_

Adresa: \_\_\_\_\_

Adresë e-mail/fax: \_\_\_\_\_

Numri i tel: \_\_\_\_\_

Përfaqësuar nga z./znj. \_\_\_\_\_

b) Zyra e përmbarimit priva/përmbaruesi gjyqësor privat \_\_\_\_\_

Adresa: \_\_\_\_\_

Adresë e-mail/fax: \_\_\_\_\_

Numri i tel: \_\_\_\_\_

Përfaqësuar nga z./znj. \_\_\_\_\_

2. Njoftimi do të ketë efekt sapo të konfirmohet dorëzimi nëpërmjet shërbimit postar apo protokollit.

## Neni 12

**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë realizimit të kësaj kontrate, zgjidhen me mirëkuptim mes palëve.

2. Nëse nuk arrihet zgjidhja me mirëkuptim dhe marrëveshje mes palëve, ato mund t'i drejtohen gjykatës së rrethit gjyqësor ku zyra e përmbarimit privat/përmbaruesi gjyqësor privat ka selinë.



## Neni 13

**Dokumentacioni bashkëlidhur kontratës**

Kësaj kontrate si pjesë përbërëse e saj i bashkëlidhen edhe dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesa e palës së interesuar që kërkon konstatimin e faktit;
2. Mandatpagesa e pagesës së shërbimit që lëshon banka;
3. Autorizimin për përdorimin e të dhënave personale, nënshkruar sipas formatit bashkëlidhur kësaj kontrate.

## Neni 14

**Parashikime të fundit**

1. Kontrata hartohet në 3 (tri) kopje me të njëjtën vlerë ligjore, ku njëra mbahet nga përmbaruesi, njëra mbahet në arkivin e zyrës së përmbarimit privat/përmbaruesit gjyqësor privat dhe tjetra mbahet nga kërkuesi/pala e interesuar. Kopjes origjinale të kontratës që mban kërkuesi/pala e interesuar, i bashkëlidhet fotokopja e akteve të parashikuara në nenin 16 të kësaj kontrate.

2. Kontrata nënshkruhet në çdo fletë, nga të dyja palët kontraktore.

## Neni 15

**Efektet, hyrja në fuqi dhe përfundimi**

1. Kjo kontratë është e vlefshme për sa është parashikuar në të deri në realizimin e objektit të kontratës.

2. Kjo kontratë hyn në fuqi menjëherë me nënshkrimin nga palët kontraktuale.

Kjo kontratë, pasi u lexua me zë të lartë dhe kuptua, u nënshkrua rregullisht nga palët, si më poshtë:

**KËRKUESI/PALA E INTERESUAR**

\_\_\_\_\_  
(emër, mbiemër, firmë)

**ZYRA E PËRMBARIMIT  
PRIVAT/PËRMBARUESI GJYQËSOR  
PRIVAT**

\_\_\_\_\_  
(vula) (emër mbiemër, firmë)

Vendi: \_\_\_\_\_

Data e nënshkrimit \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_.

## Autorizim

**Për përpunimin e të dhënave personale nga përmbaruesi gjyqësor privat**

Bazuar në nisjen e procesit të kërkuar prej meje, për kryerjen e konstatimit të fakteve, sendeve dhe dukurive lehtësisht të verifikueshme, sipas legjislacionit në fuqi, nga përmbaruesi gjyqësor privat \_\_\_\_\_, autorizoj këtë të fundit për kontrollin, përpunimin dhe trajtimin e të dhënave të mia personale sipas këtij autorizimi, që do të vlejë dhe bëhet vetëm në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, për aq kohë sa është e vlefshme Kontrata e Shërbimit lidhur më datë \_\_\_\_\_, me zyrën e përmbarimit / përmbaruesin gjyqësor privat \_\_\_\_\_.

**Nënshkrimi i deklaruesit autorizues**

\_\_\_\_\_  
(emër, mbiemër, nënshkrim)

Data e nënshkrimit: \_\_\_\_\_

**VENDIM**

**Nr. 19, datë 5.4.2023**

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT  
PARAPRAK PËR KRYERJEN E  
VEPRIMTARISË FINANCIARE SHITESË  
NGA BANKA OTP ALBANIA SHA**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 23, pikat 1 dhe 3, të nenit 24, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 204, pika 5, të ligjit nr. 52/2014, datë 22.5.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”; të nenit 18, pika 8, të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 11.3.2009, e ndryshuar; pikës 6 të shtojcës 1, të Rregullores “Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare”, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 36 datë 26.5.2010, e ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,



## VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për kryerjen nga Banka OTP Albania sh.a. të veprimtarisë financiare shtesë të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime, në rolin e brokerit.

2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për të bërë ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së Bankës OTP Albania sh.a., pas paraqitjes të licencës së dhënë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Gent Sejko

## VENDIM

Nr. 2, datë 30.3.2023

**BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË  
DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH**

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar, të kreut I, nenit 22, pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, të ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar, “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhër urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, të kryetarit të Autoritetit, “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, të ndryshuar, me urdhrin nr. 56, datë 23.3.2023, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, “Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e

informacionit të klasifikuar, “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 2, datë 30.3.2023, si më poshtë:

**I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:**

**1. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 1**, “Analizë vjetore e punës në sektorin e sigurimit të naftës për vitin 1978” me 72 (shtatëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978 (sipas ndryshimeve ligjore).

**2. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 2**, “Procesverbal i asgjësimit të dokumenteve që kanë plotësuar afatin e ruajtjes”, me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**3. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 3**, “Plani i përgatitjes profesionale dhe specialo-luftarake të punëtorit operativ”, me 3 (tri) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**4. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 4**, “Korrespondenca me Degën e Punëve të Brendshme Fier dhe Drejtorinë I mbi personat që janë marrë me përpunim vitin 1978”, me 3 (tri) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**5. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 5**, “Detyrat e lëna nga Drejtoria I pas kontrollit të ushtruar”, me 10 (dhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**6. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 6**, “Analizë mbi punën e kryer në drejtëm të agjenturës së profilizuar dhe kundër diversionit”, me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**7. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 7**, “Plan i masave për detyrat që dalin nga letra e KQPPSH-së dhe qeverisë drejtuar Kinës”, me 5 (pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**8. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 8**, “Raport për llogaridhënie në organizatën bazë të partisë”, me 10 (dhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**9. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 9**, “Plan masash agjenturore



operative me Degën e Punëve të Brendshme Vlorë, për nxjerrjen e përpunimeve e lidhjeve të tyre në atë rreth që punojnë në industrinë e naftës dhe e gazit”, me 5 (pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**10. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 10,** “Plan masash agjenturore operative me rastin e festës së 1 Majit, të votimeve dhe 28, 29 Nëntorit”, me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**11. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 11,** “Raport llogaridhënie para efektivit të degës të zëvendës drejtorit”, me 8 (tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**12. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 12,** “Konkluzionet e dala nga verifikimi i detyrave të lëna në muajin korrik 1976”, me 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**13. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 13,** “Informacion dërguar Komitetit të Partisë mbi llogaridhënien e kuadrove të Degës së Sigurimit të naftës”, me 5 (pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**14. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 14,** “Relacion mbi përgatitjen profesionale dhe gatishmërinë luftarake të kuadrit gjatë vitit 1978”, me 10 (dhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**15. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 15,** “Informacion dërguar Drejtorisë I mbi gjendjen e vendburimit të gazit Divjakë”, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**16. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 16,** “Informacion mbi rezultatet e kontrollit të ushtruar në sektorin operativ për evidentimin, studimin dhe administrimin e të dhënave të agjenturës”, me 7 (shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**17. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 17,** “Informacion

drejtuar Drejtorisë I, mbi disa komente armiqësore në Degën e Sigurimit të Naftës”, me 6 (gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**18. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 18,** “Informacion mbi disa shkelje të rënda në uzinën e përpunimit të naftës dhe atë mekanike Qytet Stalin”, me 3 (tri) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**19. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 20,** “Informacion mbi disa persona që do të dalin jashtë shtetit”, me 25 (njëzet e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**20. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 21,** “Informacion dërguar Komitetit të Partisë dhe Drejtorisë I, mbi disa mallra stoqe të bllokuara në magazinat e Ndërmarrjes së Furnizimit Teknik Patos”, me 5 (pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**21. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 24,** “Informacion drejtuar Komitetit të Partisë të Rrethit Tiranë mbi disa dobësi të konstatuara në zonën e shpimit Cakran, rajonin e Patosit, në Ballsh dhe në Institutin Gjeologjik të Naftës Fier”, me 22 (njëzet e dy) fletë. Dosja daton në vitin 1978.

**22. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 26,** “Informacion dërguar Drejtorisë I, dega 7, mbi përdorimin me efektivitet të metodave intensifikuese dhe raportimin e shifrave të realizimit të planit”, me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**23. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 27,** “Libër me të dhëna me karakter politik në Degën e Naftës”, me 13 (trembëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**24. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 28,** “Informacion mbi avaritë e ndodhura në punën e kërkimit për naftë dhe gaz në Sarandë, Ndërmarrjen Gjeologjike të naftës Lushnjë, Frakull dhe Divjakë”, me 38 (tridhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**25. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 29,** “Procesverbale



mbi asgjësimin e librave të llogarisë personale të punëtorëve operativ”, me 21 (njëzet e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**26. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 30,** “Evidenca mbi planifikimin dhe administrimin e Fondit të Veçantë për vitin 1978”, me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**27. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 31,** “Letra e Këshillit të Ministrave dhe akt kontrolli mbi masat për ruajtjen e sekretit dërguar Degës së Punëve të Brendshme dhe Komitetit të Partisë”, me 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**28. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 32,** “Akt kontrolli në sektorin e evidencës agjenturialo-operative në Degën e Përpunimit të naftës mbi punën dhe gjendjen e këtij sektori”, me 5 (pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**29. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 33,** “Relacion mbi evidentimin, ndjekjen dhe zgjidhjen e kërkesave dhe ankesave gjatë vitit 1978”, me 7 (shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**30. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 34,** “Informacion dërguar organeve dhe reparteve të Punëve të Brendshme për zbatimin e regjimit të vendosur për fletoret e shënimeve sekrete”, me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**31. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 35,** “Korrespondenca e Degës së Përgjithshme me Degën e Sigurimit të naftës mbi punën e bërë për shkurtimin e korrespondencës”, me 9 (nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**32. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 36,** “Detyra orientuese për vitin 1978 të sektorit të kartotekës”, me 9 (nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**33. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 37,** “Informacion mbi gjendjen e dokumenteve në dosjet e përpunimit agjenturial”, me 5 (pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**34. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 38,** “Detyra të nxjerra nga studimi i letrës së KQ-së, si dhe porositë e ministrit për punën e sigurimit”, me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**35. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 39,** “Procesverbal për dorëzimin e dokumenteve me vlerë arkivore”, me 3 (tri) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**36. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 40,** “Informacion dërguar Drejtorisë I mbi trajtimin e materialeve gjeologjike të karakterit sekret”, me 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**37. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 41,** “Raport mbi punën e bërë për rritjen e vigjencës së masave të punonjësve dhe aktivizimin e tyre kundër veprimtarisë armiqësore në industrinë e naftës dhe gazit”, me 7 (shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**38. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 42,** “Informacion dërguar Drejtorisë së Policisë për nevoja pajisjesh zjarrfikëse”, me 6 (gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**39. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 43,** “Informacion dërguar Drejtorisë Operative të Përgatitjes dhe Drejtorisë së Policisë Popullore mbi përgatitjen e reparteve të mjeteve kundra zjarrit”, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**40. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 44,** “Plan masash për zbatimin e urdhrit të ministrit për forcimin e masave të mjeteve kundra zjarrit në objekte”, me 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.



41. **Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 46**, “Pasqyra mbi ngjarjet e ndodhura, masat disiplinore, stimujt moral të sektorit të mjeteve kundra zjarrit”, me 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

42. **Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 47**, “Informacion drejtuar Drejtorisë së Kuadrit mbi punimin e letrës të Komitetit Qendror të PPSH për zgjedhjen e punonjësve që ngarkohen me përgjegjësi materiale”, me 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

43. **Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 48**, “Analizë vjetore e punës së shërbimit të mbrojtjes kundër zjarrit në industrinë e naftës dhe gazit”, me 28 (njëzet e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

44. **Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 49**, “Pasqyra statistikore dërguar degës së organizim kompletimit mbi ngjarjet e ndodhura, masat disiplinore, stimujt moral”, me 24 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

45. **Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 50**, “Statistika dërguar organizim kompletimit mbi gjendjen organike dhe të personelit, automjeteve dhe armatimeve për periudhën tetor 1979 – shtator 1978”, me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

46. **Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 51**, “Informacion dërguar Degës së Kuadrit mbi kryerjen e punës prodhuese të degës për vitin 1978”, me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

47. **Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 52**, “Informacion dërguar Degës së Kuadrit mbi gjendjen e masat për forcimin e disiplinës në punë dhe raporti për kuadrin e Degës së Sigurimit të Naftës për vitin 1978”, me 22 (njëzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

48. **Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 53**, “Të dhëna mbi vërejtjet e kuadrove punëtor operativ në Degën e Sigurimit të Naftës për vitin 1971–1978”, me 5

(pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

49. **Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 54**, “Statistika dërguar Degës së Kuadrit mbi vazhdimin e shkollës pa shkëputje nga puna të efektivit të Degës së Sigurimit të Naftës”, me 3 (tri) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

50. **Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 55**, “Informacion dërguar Drejtorisë Ekonomike mbi inventarizimin vjetor të vlerave materiale dhe të sektorit të armatimit në Degën e Sigurimit të Naftës”, me 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

51. **Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 56**, “Evidenca e sektorëve të plan intendencës për vitin 1978 dërguar Drejtorisë Ekonomike”, me 8 (tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

52. **Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 58**, “Akt kontrolli mbajtur në Degën e Sigurimit të Naftës në sektorin ekonomik financiar”, me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

53. **Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 59**, “Plan masash agenturialo-operativ i përbashkët me Degën e Punëve të Brendshme për ndjekjen e përpunimeve dhe lidhjeve të tyre”, me 5 (pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

54. **Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 60**, “Situacioni mbi zbatimin e buxhetit për vitin 1978 dhe treguesve të tjerë financiar dërguar degës së kontroll financës”, me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

55. **Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 61**, “Fletinventarët e dosjeve të bashkëpunëtorëve për vitin 1978”, me 111 (njëqind e njëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Tepër sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

56. **Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 62**, “Procesverbal të sektorit të armatimit të Degës së Sigurimit të



Naftës mbi studimin dhe vlerësimin e dosjeve formulare të personave në përpunim paraprak dhe aktiv, si dhe të bashkëpunëtorëve”, me 60 (gjashtëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Tëpër sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**57. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 63,** me 3 (tri) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**58. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 64,** me 3 (tri) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**59. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 65,** me 9 (nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**60. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 66** me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**61. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 3, dosje nr. 68,** me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1978.

**62. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 4, dosje nr. 1,** “Projektplan i furnizimit material, evidencat e sektorëve, plani për vitin 1979 dhe projekt plani 5-vjeçar 1981–1985 dërguar Drejtorisë Ekonomike”, me 44 (dyzet e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1979.

**63. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 4, dosje nr. 2,** “Akt kontrolli në Degën e Kuadrit në Degën e Sigurimit të Naftës për përgatitjen profesionale të kadrove të larta si dhe mbi vazhdimin e arsimit pa shkëputje nga puna”, me 6 (gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1979.

**64. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 4, dosje nr. 3,** “Raport dërguar Drejtorisë së Kuadrit mbi punën e kryer nga kadri në Degën e Sigurimit të Naftës gjatë vitit 1979”, me 6 (gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1979.

**65. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 4, dosje nr. 4,** “Informacion drejtuar degëve ushtarake të rretheve mbi shenjat personale të ushtarakëve dhe punonjësve civil si dhe listat emërore të tyre”, me 8 (tetë) fletë. Niveli i

klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1979.

**66. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 4, dosje nr. 5,** “Informacion dërguar Drejtorisë së Kuadrit mbi evidentimin e kohës së punës të punonjësve civil në Degën e Sigurimit të Naftës”, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1979.

**67. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 4, dosje nr. 6,** “Raport statistikor drejtuar Degës së Organizim Kompletimit mbi organikën dhe efekteve të personelit, armatimeve, automjeteve në Degën e Sigurimit të Naftës në vitin 1979”, me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1979.

**68. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 4, dosje nr. 7,** “Informacion dërguar Drejtorisë së Kuadrit mbi transferimin e oficerëve jashtë vendit”, me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1979.

**69. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 4, dosje nr. 8,** “Informacion drejtuar Drejtorisë së Kuadrit dhe Degës së Organizim Kompletimit mbi propozimet për dekorim”, me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1979.

**70. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 4, dosje nr. 9,** “Pasqyra statistikore dërguar Degës së Organizim Kompletimit mbi emërimin në shërbim aktiv të përhershëm në Degën e Sigurimit të naftës”, me 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1979.

**71. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 4, dosje nr. 10,** “Pasqyra statistikore drejtuar Degës së Organizim Kompletimit mbi ngjarjet e ndodhura, masat disiplinore, dhe stimujt moral të efektivit nënoficer e polic”, me 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1979.

**72. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 4, dosje nr. 11,** “Informacion dërguar zyrës së kërkesë ankesave mbi evidentimin, ndjekjen dhe zgjidhjen e kërkesave, ankesave të shtetasve”, me 7 (shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1979.





73. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 4, dosje nr. 12, “Informacion mbi rezultatet e kontrollit për ruajtjen e sekretit në disa institucione e Ndërmarrje Ekonomike të Industrisë së Naftës dhe Gazit”, me 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1979.

74. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 4, dosje nr. 13, “Informacion dërguar Degëve të Punëve të Brendshme në degë dhe rrethe mbi shfuqizimin e shkresës nr. 598 -për shfrytëzimin e literaturës së huaj”, me 3 (tri) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1979.

75. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 4, dosje nr. 14, “Akt kontrolli mbi punën e kryer për dërgimin e dokumenteve të Degës së Sigurimit të Naftës me vlerë arkivore në arkivin e MPB-së si dhe procesverbali i këtyre dokumenteve”, me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1979.

76. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 4, dosje nr. 15, “Raport mbi punën me agjentinë dhe masat për rritjen cilësore”, me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1979.

77. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 4, dosje nr. 16, “Evidenca e shfrytëzimit të mjeteve teknike drejtuar Drejtorisë Ekonomike, Degës Mekanike, si dhe modelarët për kujdestarët dhe magazinierët dërguar organeve dhe reparteve të Punëve të Brendshme”, me 10 (dhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1979.

78. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 4, dosje nr. 17, “Projekt plani financiar dhe situacioni i zbatimit të buxhetit për vitin 1979, si dhe akt kontrolli ekonomik financiar i pesëvjeçarit të 7 të vitit 1981–1985 për këtë sektor”, me 34 (tridhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1979.

79. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 4, dosje nr. 18, “Detyrat orientuese vjetore për vitin 1979”, me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1979.

80. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 4, dosje nr. 19, “Detyrat vjetore të sektorit të mjeteve kundër zjarrit për vitin 1979 dhe raporti i punës së sektorit”, me 28 (njëzet e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1979.

81. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 4, dosje nr. 20, “Informacion dërguar Drejtorisë I, Degës VII mbi gjetjen e një shiriti metalik në pusin e kërkimit për naftë dhe gaz dhe një avari në impiantin e naftës në Cakran”, me 7 (shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1979.

82. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 4, dosje nr. 21, “Informacion drejtuar Komitetit të Partisë në rrethe, Drejtorisë I dhe Degës VII mbi disa të meta dhe mangësi në shfrytëzimin e disa puse naftë në qytetin Stalin”, me 6 (gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1979.

83. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 4, dosje nr. 22, “Informacion drejtuar Komitetit të Partisë në rrethe, Drejtorisë I dhe Degës VII mbi avaritë në pusët Frakull, Ballsh, Kulla 1 Durrës, dhe mbi disa koncepte që frenojnë kërkimin e gazit në Divjakë Lushnje”, me 22 (njëzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1979.

84. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 4, dosje nr. 23, “Informacion dërguar Degës së Sigurimit të Naftës mbi kërkesën për një përkthyes”, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1979.

85. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 4, dosje nr. 24, “Informacion dërguar Drejtorisë I, Degës së 8-të mbi disa komente armiqësore”, me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1979.

86. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 4, dosje nr. 25, “Informacion dërguar Drejtorisë I dhe Degës së Punëve të Brendshme në rrethe mbi marrjen në përpunim paraprak të disa personave”, me 9 (nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1979.

87. Fondi nr. 132, Dega e Sigurimit të Naftës, kutia nr. 4, dosje nr. 26, “Informacion drejtuar Drejtorisë I, Degës 4 mbi planifikimin e



shpenzimeve të Fondit të Veçantë për vitin 1979”, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është, “Sekret”. Dosja daton në vitin 1979.

